



Kompania Rajonale e Ujësjiellësit
Regional Water Supply Company
Regionalna vodovodna kompanija

KRU "GJAKOVA" SH.A. Gjakovë			
Marrë në datën: 24.04.2025			
Njësia org.	Numri	Shtojca	Vlera
	1245		

Mbështetur në Ligjin Nr. 03/L-087, "Mbi Ndërmarrjet Publike", i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-111 dhe Ligjin Nr.05/L-009, si dhe në bazë të Ligjit Punës NR 03/L-212, neni 12 paragrafi 1 pika 1.2, Bordi Drejtorëve në mbledhjen e jashtëzakonshme nr. 4 të mbajtur me datë 24.04.2025 pas shqyrtimit të Vendimit nr.1227 të datës 22.03.2025, në lidhje me çështjen e Kryeshefit Ekzekutiv z.Hasan Krasniqi, me 6 vota pro unanimisht merr këtë ;

V E N D I M

- I. Shfuqizohet vendimi nr.1227 dt. 22.03.2025 mbi largimin e përkohshëm nga puna për z.Hasan Krasniqi - Kryeshef Ekzekutiv i KRU "Gjakova" SH.A. Gjakovë.
- II. z. Hasan Krasniqi i sistemuar në vendin e punës si Kryeshef Ekzekutiv i KRU. "Gjakova" SH.A. – Gjakovë, është i obliguar që të paraqitet në punë me datë 24.04.2025.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve.

A R S Y E T I M

Bordi Drejtorëve i KRU. "Gjakova" SH.A.- Gjakovë, në mbledhjen e jashtëzakonshme nr. 4 të mbajtur me datë 24.04.2025, ka shqyrtuar njoftimin e avokatit të z.Hasan Krasniqi se të njëjtit me datë 17.04.2025, i është përfunduar me skadim masa e paraburgimit, dhe ndaj tij kanë pushuar arsyet për largim të përkohshëm nga puna, në këtë kuptim nuk ka pengesa ligjore për ushtrimin e detyrave si dhe përgjegjësi si Kryeshef Ekzekutiv.


Andaj bazuar nga të cekurat si më lartë, si dhe në pajtim me dispozitat ligjore të Nenin 12 paragrafi 1 pika 1.2 të Ligjit të Punës në Kosovë, Bordi Drejtorëve i KRU "Gjakova" SH.A.- Gjakovë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshilla juridike – kundër këtij vendimi lejohet ankesa në afat prej 8 ditë.

Iu dërgohet ;

- Ministrisë së Ekonomisë
- Njesisë Për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
- Z.Hasan Krasniqi
- Arkivit të Kompanisë

Kryesues i Bordit të Drejtorëve


Z. Urim Gashi
